



Prot. 13/2022

Rrëshen, 25 shkurt 2022

Të dashur meshtarë, rregulltarë, rregulltare e besimtarë laikë,

Për shkak të situatës së rënduar në Ukrainë, ftesës së Papa Françeskut dhe të Presidentit të CCEE, Mons Gintaras Grusas, për t`u lutur për popullin ukrainas, i bashkohemi edhe ne si Kishë në Shqipëri.

Kështuqë me datë 2 mars 2022, ditën e fillimit të Kreshmes, përveç njetit për shpirtrat e vëllezërve e motrave të vdekura për shkak të COVID-19, do të lutemi edhe për paqen në Ukrainë, duke u solidarizuar me vuajtjen e popullit ukrainas, me viktimat dhe familjet e tyre.

Prandaj porositni të gjithë besimtarët që të bashkohen në këtë nismë, me lutje dhe me agjërim, që Hyji t`u ndriçojë mendjen dhe zemrën përgjegjësve të kësaj lufte për të gjetur rrugët e paqes e pajtimit e gjithashtu të pranojë në Mbretërinë e tij vëllezërit e motrat e vdekur nga COVID-19.

Duke ju uruar një kohë të frytshme kreshmesh ju përshëndes,

Vllazërisht në Krishtin

+ doni Gjergj Meta

+ Gjergj Meta

*Ipeshkëv i Rrëshenit e Sekretar i Përgjithshëm KISH*